



REPUBLIKAE SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5385 prot.

Himarë, më 11.07.2025

VENDIM

Nr. 34, Datë 09.07.2025

PËR

**“PËR MIRATIMIN E KAHUT TË LËVIZJES, ORARIT TË LËVIZJES DHE  
KUFIZIMIT TË QARKULLIMIT NË DISA AKSE TË BRENDSHME SË MJETEVE  
AUTOMOBILISTIKE NË QYTETIN E HIMARËS”**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8378/1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i përditësuar datë, 16/03/2023), ligjin nr.89/2022 “Për policinë bashkiake”, VKM-në nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës Së Shqipërisë” (përditësuar me VKM nr.322, datë 29/05/2024); me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë: Këshilli i Bashkisë Himarë në mbledhjen e datës 09.07.2025 , pasi shqyrtoi materialin e sjell drejtoria juridike e miratoi me trembëdhjetë (13) vota pro , tre (3) vota kundër , zero (0) abstënim dhe si më poshtë ,

VENDOSI

1. Miratimin e kahut të lëvizjes, orarit të lëvizjes dhe kufizimit të qarkullimit në disa akse të brendshme së mjeteve automobilistike në qytetin e Himarës sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes sektorëve teknikë dhe urbanistikës, të vendosë sinjalistikën e nevojshme rrugore.
3. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes Policisë Bashkiake të kontrollojë zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes njërive të komunikimit të bashkisë të informojnë publikun për ndryshimet përmes mjeteve zyrtare dhe çdo forme të komunikimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar ne ligjin nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", neni 55 pika 6.

KRYETARI  
Dhimitër Kapaj





